



HISTORIA JONE

Bazuar në vlera
Fokusuar në arritje

**Zhvilluar/krijuar
në partneritetet
të ngushtë**





HISTORIA JONE

Bazuar në vlera

Fokusuar në arritje

Zhvilluar/krijuar në partneritet të ngushtë

Kjo broshurë u përgatit nga MEDPAK me mbështetjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas”, të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk janë domosdoshmerisht ato të UNDP-së apo Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.



Av. NAZMI KOKA
Kryetar i parë MEDPAK

***... si prindër me përvojë jetësore, ne
ju bëjmë thirrje të bashkoheni në
misionin tonë të përbashkët për të
mbrojtur e garantuar deri në fund
të drejtat e mohuara të fëmijëve
tanë.....***

MESAZH

Të dashur prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar,

Ju nuk e kishit menduar kurrë se do të përballeshit në jetë me një vështirësi të tillë, kur keni përditë para fëmijën, pjesë e zemrës dhe të e jetës, që ka aftësi të kufizuar dhe nuk mund të zhvillohet dhe të përballojë vetë jetën. Çfarë nuk do të jepnit që edhe ai të ishte i gëzuar si gjithë të tjerët. Por ju me punën tuaj këmbëngulëse, me forcimin e dashurisë si bashkëshortë dhe duke ja manifestuar këtë fëmijës, do ta bëni me lumturinë tuaj të lumtur edhe atë. Duke qenë të lumtur me njëri tjetrin ju jeni me fisnikë dhe kurajoz.

Si prindër me përvojë jetësore, ne ju bëjmë thirrje të bëheni pjesë e qenies të bashkuar në misionin tonë të përbashkët për të luftuar deri në fund për të drejtat e mohuara të fëmijëve tanë.

Këtë mos e prisni nga të tjerët, po qe se vetë nuk bëheni pjesë e vetëveprimit nëpërmjet strukturave institucionale të legalizuara sikurse janë shoqatat e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Të kuptojmë

se ju jeni mbrojtja e fëmijës suaj, se ju jeni engjëlli mbrojtës i tij. Të mos lejojmë që të kalojmë nga ëndrra tek deziluzioni, por me kurajo e dashuri për njeri tjetrin te kalojmë gjithçka së bashku dhe të bashkuar, me kurajo dhe vullnet, sepse të vetmuar nuk mund të arrini asgjë.

Duhet të jemi të ndërgjegjësuar, që duke kërkuar këto të drejta të gjejmë qetësinë, pasi jemi në një ankth të vazhdueshëm se si do të bëhet me fëmijët tanë kur ne nuk do të jemi. Pra për të krijuar këtë siguri të përgatisim një kuadër praktik të jetesës së tyre me dinjitet. Kështu do të jemi relativisht të qetësuar se kemi bërë çfarë është në mundësinë tonë për fëmijët tanë, që janë pjesë e jetës sonë. Për prindin pavarësia që fiton fëmija në jetë është ajo që kërkohet të arrihet, por për fëmijët tanë, në se arrijmë që ata të shërbejnë vetes së tyre, kemi bërë të pamundurën.

Përzemërsisht
Av. NAZMI KOKA
Kryetar i parë MEDPAK

(nga dorëshkrimet e tij)

... rruga jonë

MEDPAK është një shoqatë jofitimprurëse e krijuar në vitin 1993, në qytetin e Librazhdit, nga prindër me fëmijë me aftësi të kufizuar, Kjo shoqatë lindi si nevojë për mbrojtje e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Me kalimin e viteve nga nevoja e kërkuar dhe nga eksperiencia e fituar shoqata e zgjeroi veprimtarinë e saj në gjithë Shqipërinë.

Në vitin 1994 u hap e para Qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar, në qytetin e Librazhdit.

Më pas në vitin 1996 u trajnuan disa mësues për arsimin special të integruar. Ishte koha kur nga izolimi duhej integrimi i personave me aftësi të kufizuar në shoqëri.

Në Shtator të vitit 1996 u hap një klasë e edukimit special të integruar për fëmijët me aftësi të kufizuar në shkollën 8-vjeçare “Genc Leka” Librazhd.

Në Tetor 1998, 20 mësues nga rrethi Librazhdit u trajnuan për arsimin special nga shoqata “Children’s Aid Direct”

Në Shtator të vitit 1999 në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Librazhd dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ne hapëm edhe një klasë të edukimit special për fëmijët me Aftësi të kufizuar në qytetin e Përrenjasit.

Në vitin 2000 bëmë studimin dhe vlerësuam nevojat për gjithë njerëzit me Aftësi të Kufizuar në rrethin e Librazhdit.

Pas këtij studimi në Shtator 2000-2003 me fonde të UNICEF ne filluam arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar duke i integruar ata në shkollat pranë vendbanimit të tyre në gjithë rajonin e Elbasanit, rreth 315 fëmijë të moshës 6-10 vjeç.

Në Dhjetor të 2002 në qytetin e Librazhdit, në partneritet me Bashkinë Librazhd dhe shoqatën “Save the Children” Shqipëri, për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të rënduar hapëm një Qendër ditore, e cila frekuentohej nga fëmijë me Aftësi të Kufizuar të rënduar të qytetit të Librazhdit dhe disa fëmijë nga qytetit i Elbasanit. Me hapjen e kësaj Qendre ne si shoqatë zbatuam të drejtën për arsim për fëmijët me Aftësi të Kufizuar dhe integrimin e tyre në komunitet.

Në vitin 2003 shoqata hapi një Qendër Burimore për aftësinë e kufizuar në qytetin Librazhdit e cila krijon lehtësi për prindërit jo vetëm për këtë qytet por për gjithë rajonin e Elbasanit.

STAFI NDËR VITE





VIZIONIYNË

**Të barabartë në të drejta,
të ndryshëm në nevoja.**

MISIONI

Mbrojmë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përmes njohjes e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, trajnimit të anëtarëve e më gjerë, sensibilizimit të komunitetit për rritjen e kërkesave për zbatimin e ligjeve, krijimin e shërbimeve, me qëllim arritjen një jete dinjitoze për të gjithë.

Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara” (MEDPAK) është një organizatë jofitimprurëse (OJF), vullnetare, humanitare, bamirëse e cila ka për synim që të mbrojtë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. **MEDPAK** është krijuar si shoqatë prindërisht të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Maj 1993. Në mars të 2006 me vendim Nr.1620 datë 06.03.2006 të gjykatës së shkallës së parë Tiranë, nga një shoqatë lokale është shndërruar në një shoqatë me një shtrirje në të gjithë vendin nëpërmjet degëve të saj. MEDPAK ka tani 8 degë në Bashkitë Elbasan, Korçë, Dibër, Librazhd, Përrenjas, Belsh, Cërrik dhe Berat.

MEDPAK është shoqatë aktive e përfshirë në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Si pjesë e grupit të advokacisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, MEDPAK ka dhënë e jep një oponencë reale për lobimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore për personat me Aftësi të Kufizuara.

MEDPAK vazhdon të jetë

- anëtare e Aleancës Kombëtare për Fëmijë,
- anëtare e grupit të advokacisë ngritur pranë dhe me iniciativën e FSHDP,
- anëtare e rrjetit të shoqatave të Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar,
- anëtare e Koalicionit Shqiptarë Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi.

QËLLIMI I MEDPAK

Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

VLERAT

Integriteti: Ne mbështesim idenë se marrëdhëniet ku mbizotëron besimi japin edhe më shumë rezultate në punën tonë. Kjo është arsyeja që ne përpiqemi të fitojmë besimin e fëmijëve, të rinjve, prindërve, partnerëve tanë, donatoreve e të gjithë grupeve me të cilët punojmë. Puna dhe bashkëpunimi jonë karakterizohet nga ndershmëria, korrektësia, paanshmëria dhe integriteti.

Respekti: Ne shfaqim konsideratë dhe vlerësojmë aftësitë, meritat, cilësitë dhe rëndësinë e çdo individi. Ne jemi të përkushtuar që t'i trajtojmë të gjithë individët me respekt dhe në mënyrë të paanëshme, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, kombësia, gjinia, besimi fetar apo aftësia.

Besnikëria: Ne respektojmë privatësinë dhe kofiden-cialitetin bazuar në ligj dhe në statut.

Profesionalizmi: Çdo punonjës është përgjegjës për cilësinë e punës së tij/saj dhe përpiqet ta bëjë punën e tij/saj sa më mirë. Çdo punonjës është i përkushtuar të krijojë praktika dhe modele pozitive në fushën e aftësisë së kufizuar.

Kujdesi: Puna dhe përkushtimi jonë prek dhe përpiqet të përmisojë cilësinë e jetesës të çdo personi me aftësi të kufizuar, familjes dhe shoqërisë që e rrethon. Për këtë arsye ne jemi të përkushtuar për të qenë sa më të kujdesshëm për të përmbushur nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Ne punojmë me profesionistë për të arritur misionin tonë.

Uniteti: Uniteti dhe solidariteti i stafit bazuar në qëllime të përbashkëta na frymëzon për të dhënë më të mirën nga vetja duke arritur rezultate në punë tonë.

MEDPAK

3-DHJETORI

DITA NDERKOMBETARE

E ME





- Jemi të sjellshëm për të dëgjuar dhe kuptuar.
- Jemi të gjindshëm dhe të gatshëm.
- Vlerësojmë çdo sugjerim për të përmirësuar punën tonë.
- Pranojmë përgjegjësinë për veprimet tona.
- Ofrojmë gjithmonë shërbim cilësor dhe përkushtim.
- Veprojmë gjithmonë në mënyrë profesionale dhe etike.

MEDPAK që nga fillimi i veprimtarisë së saj si shoqatë ka përqendruar veprimtarinë në drejtim të :



1. Edukimit të nënave dhe familjeve për të punuar me fëmijët e tyre që në fëmijërinë e hershme.
2. Trajnimit të stafit të mësuesve në institucionet arsimore dhe edukatoreve të çerdheve me qëllim rritjen e njohurive për të punuar praktikisht me fëmijë me aftësi të kufizuara.
3. Arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla pranë vendbanimit të tyre së bashku me bashkëmoshatarët, duke synuar realizimin e arsimit gjithëpërfshirës,
4. Dhënies së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht të rënduar në Qendra ditore, pranë vendbanimit të tyre.
5. Ofrimit të mbështetjes juridike falas për gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
6. Advokimit dhe lobimit me organet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara.

Çfarë bën aktualisht **MEDPAK**

QENDËR BURIMORE

- Në Qendrën burimore të MEDPAK mbliidhen, dokumentohen dhe shpërndahen informacione në fushën e aftësisë së kufizuar .
- Jepen këshillime sociale dhe ligjore për personat me aftësi të kufizuar, prindërve, familjarëve dhe kujdestarëve të tyre.

QENDËR TRAJNIMI

- Trajnimet e MEDPAK fokusohen në:
- Fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.
- Fushën e arsimit gjithëpërfshirës.
- Rritjen e njohurive të prindërve në drejtim të përkujdesjes e mirërritjes së fëmijëve të tyre.

MEDPAK ka disa module te akredituara nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ASCAP.

QENDËR DITORE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM

MEDPAK ofron shërbim direkt për fëmijët me aftësi të kufizuar në gjendje veçanërisht të rëndë. MEDPAK është i licencuar sipas ligjit për shërbime në komunitet.

ADVOKIM DHE SENSIBILIZIM

Nëpërmjet buletineve periodike, ditëve të informacionit dhe takimeve të drejtpërdrejta, MEDPAK punon për ndërgjegjësimin e gjithë komunitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. MEDPAK advokon dhe lobon në institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit në fuqi për aftësinë e kufizuar.







Disa nga objektivat kryesore të MEDPAK janë:

1. Të zgjerojë shtrirejn e dëgeve të shoqatës për çdo njësi të qeverisjes vendore.
2. Të punojë me qëllim realizimin e së drejtës për arsimim të të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuar duke synuar realizimin e arsimit gjithëpërfshirës.
3. Të informojë familjet dhe vetë personat me aftësi të kufizuar për të drejtat e tyre të mbrojtura nga legjislacioni shqiptar.
4. Të monitorojë shërbimet e dhëna në Qendra ditore e rezidenciale për personat me aftësi të kufizuar.
5. Të japë ndihmë juridike falas gjithë personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre për realizimin e të drejtave dhe rivendosjen e të drejtave të shkelura nëpërmjet proceseve gjyqësore.

Me synimin
“Ne jemi si gjithë të tjerët”
MEDPAK punon për:



- Njohjen, propagandimin dhe zbatimin e të drejtave të afirmuara në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuara.
- Lobimi pranë institucioneve përkatëse për të kërkuar zbatimin e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe akteve ndërkombëtare, ku shteti ynë është palë.
- Ofrimi i sugjerimeve të vazhdueshme me qëllim përmirësimin e legjislacionit dhe përfaqsimin e tij me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut.
- Për integrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara dhe krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.
- Krijimin e qendrave rezidenciale në interes të shërbimit ndaj këtyre personave, si dhe ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare për personat me aftësi të kufizuara.
- Zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës në zbatim të dispozitave ligjore detyruese të miratuara për këtë qëllim.
- Ngritjen e shërbimeve me synim përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri duke ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe krijimin e shërbimeve të reja mbështetëse nga organet shtetërore përkatëse.
- Ndërgjegjësimin e opinionit publik, sensibilizimin e tij për krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse dhe përfshirje sociale të personave me aftësi të kufizuara.



- Nxitjen e studimeve në fushën e aftësisë së kufizuar.
- Luftën kundër diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara si dhe marrjen në mbrojtje direkt në instancat përkatëse për rivendosjen e të drejtave të shkelura.
- Mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara duke i kërkuar organeve shtetërore barazinë para ligjit.
- Krijimin e Qendrave ditore si dhe ofrimin e shërbimeve për riaftësimin e personave me aftësi të kufizuara me qëllim integrimin e tyre për jetesë të pavarur në komunitetin ku banojnë.
- Lobimin me organet shtetërore përgjegjëse për legjislacionin në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuara.
- Monitorimin e shërbimeve që kryhen nga ofruesit publikë dhe privat duke kërkuar zbatimin e legjislacionit dhe cilësinë e shërbimeve në përputhje me standardet bashkëkohore.
- Trajnimin e ofruesve të shërbimeve në përputhje me standardet e miratuara nga legjislacioni shqiptar të bazuara Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Permirësimin e stadardeve të ofruesve të shërbimeve publikë dhe private për të krijuar një jetesë sa më të pavarur për personat me aftësi të kufizuara.

PROJEKTET E ZBATUARA

Në vitin 1994 u hap Qendra Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar në qytetin e Librazhdit në ambientin e çerdhes së këtij Qyteti.

Në shtator të 1995 në Librazhd me një projekt të VSO (Shërbim Vullnetar Përtej Detit) erdhi vullnetarja nga UK, Ann Norris e cila vazhdon të kontribuojë për Shoqatën edhe tani.

Në qershor të 1996 nën udhëheqjen e Ann Norris u zhvillua trajnimi i parë me disa mësues për Arsimin Special të Integruar.

Në Shator 1996 me kërkesë të shoqatës dhe miratim të Ministrisë së Arsimit në shkollën 8-vjeçare “Genc Leka” në Librazhd u hap për herë të parë brenda shkollës klasa speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Hapja e kësaj klase brenda shkollës ishte modeli i parë i integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollë.

Në Tetor 1998, 20 mësues nga rrethi Librazhdit u trajnuan për arsimin special nga shoqata “Children’s Aid Direct”.

Në vitin 2000 MEDPAK zhvilloi një studim dhe vlerësim mbi nevojat e personave me aftësi të kufizuar në rrethin e Librazhdit.

Në vitet 2000-2003 me fonde të UNICEF ne filluam arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar duke i integruar ata në shkollat pranë vendbanimit të tyre në gjithë rajonin e Elbasanit. Rreth 315 fëmijë të moshës 6-10 vjeç shkuan për herë të parë në shkollë. Ky projekt nxiti edhe një rishikim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

Në Dhjetor të 2002 në qytetin e Librazhdit, në partneritet me Bashkinë Librazhd dhe me mbështetje të shoqatës “Save the Children” Shqipëri, u hap Qendra Ditore për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të rënduar e cila frekuentohet nga fëmijë me aftësi të kufizuar të rënduar të qytetit të Librazhdit dhe disa fëmijë nga qytetit i Elbasanit. Tani pas 18 vitesh kjo Qendër është shndërruar në një Qendër Komunitare për PAK në Bashkinë Librazhd. Sot ofrohen shërbime ditore dhe shërbime të specializuara, logopedi, fizioterapi, aftësim për jetën dhe terapi zhvillimi.

Në vitin 2003 me ndihmë të Rotary Club dhe kontribut të kryetarit të parë të saj z. Nazmi Koka shoqata hapi një Qendër Burimore për Aftësinë e Kufizuar në qytetin e Librazhdit, e cila krijoi lehtësi për rritjen e kapaciteteve të prindërve dhe fuqizimin e shoqatës.

Në vitin 2004 u krye studimi “Vlerësim i nevojave të fëmijëve me Aftësi të Kufizuar për Arsimin Special të Integruar në Bashkinë e Tiranës”. Gjate realizimit te projektit në bashkëpunim me shërbimin social, në zbatim të Dispozitave Normative u realizua integrimi i fëmijëve me Aftësi të Kufizuar në shkollat publike të arsimit të detyruar.

Në Dhjetor te 2004 ekspertë të shoqatës sonë realizuan studimin me temë “Raport studimor mbi efektivitetin e zbatimit të kuadrit ligjor që garanton edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në kushtet e arsimit gjithëpërfshirës përvojë rajonale, arritje, sugjerime dhe sfida për të ardhmen”.

Në vitin 2005 MEDPAK zbatoi projektin “Vota ime ka të njëjtën vlerë me votën tënde” në Bashkinë e Librazhdit me fonde të Programit për Demokraci të Ambasadës Amerikane.

Në vitin 2008 – 2012 MEDPAK në partneritet me Save the Children dhe me mbështetje të tyre filloi në 4 rajone të vendit në Librazhd, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastrë projektin “Arsimi Gjithëpërfshirës”.

Në vitin 2011 – 2012 në partneritet me shoqatën Poraka Nova, Strugë, MEDPAK zbatoi projektin “Parandalimi i aftësisë së kufizuar nëpërmjet edukimit për një shtatzëni të shëndetshme”. Ky projekt u financua nga Programi IPA, me fonde të BE.

Në vitin 2011-2012 me fonde të shoqatës Assist Impact u zbatua projekti “Punësimi i grave me aftësi të kufizuara” nga ku u punësuan në biznesin privat 30 gra.

Në vitin 2012-2014 MEDPAK në partneritet dhe me mbështetje të Save the Children në Shqipëri ,në 7 rajone të vendit u zbatua projekti “Arsimi gjithëpërfshirës qasje holistike”.

Në vitin 2014-2017 në partneritet dhe me fonde të Save the Children në 7 rajone të Shqipërisë : Gjirokastrë,Vlorë, Elbasan, Korçë, Durrës , Burrel dhe Dibër u zbatua projekti “Drejt një edukimi gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët në Shqipëri”

Në vitin 2017 me fonde të UNDP u krijua “Rrjeti i Organizatave të Prindërve” në qarkun e Elbasanit , ku u bënë bashkë në drejtim të punës për PAK katër organizata prindërishe, Qendra Future for You, Qendra Për Zhvillim Dhe Integrim Te Njerëzve me Nevoja të Veçanta, Shoqata Alternative dhe MEDPAK.



PROJEKTET E ZBATUARA

Në vitin 2017-2019 në Qendrën Komunitare Librazhd me fonde të WorldVision u zbatua projekti “Qendër Komunitare për Fëmijët me Aftësi të kufizuara”. Projekti u zbatua në Bashkinë Librazhd. Në këtë projekt u ofruan shërbime të fizioterapisë dhe logopedisë për 84 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Në vitin 2018-2019 në katër njësi administrative të bashkisë Elbasan u zbatua projekt “Më lejo dhe mundëso përfshirjen time” (Programi ReLoAD) UNDP me fonde të BE.

Në vitin 2019 me fonde të Lëviz Albania, MEDPAK zbatoi projektin “Unë votoj dhe kam të drejtë të dëgjohem”.

Në vitin 2017-2020 në partneritet dhe financiar nga të Save the Children në 2 rajone të Shqipërisë, në Elbasan dhe Korçë u zbatua projekti “Drejt një edukimi gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët në moshë parashkollore në Shqipëri”.

Në vitin 2019-2020 MEDPAK zbatoi me fond të BE në kuadër të programit ReLoAD , UNDP projektin “Shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara”.

Në vitin 2018-2021 është duke u zbatuar nga WorldVision Shqipëri si organizata drejtuese, në bashkëpunim me organizatën Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të kufizuara (MEDPAK) dhe Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara (ADRF), me fond të BE projekti “Rritje e Kapaciteteve të Shoqërisë Civile për të mbrojtur të drejtat e personave me AK “.

Në Qershor – Shtator 2020 MEDPAK po zbaton me fonde të UNDP projektin “Fuqizimi i prindërve në shoqatë”.

Në vitin 2020 ‘MEDPAK me mbështetjen e UNDP-së po zbaton projektin “Fuqizimi i prindërve në shoqatë’ në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas’ të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



ÇMIMET





Në Dhjetor të 2004, MEDPAK u vlerësua me **Çmim të parë nga “Handicap International”**. Ky çmimi u dha për “Shërbime më të mira me bazë komunitare”. Në dhënien e çmimit u vlerësua eksperiencia dhe përvoja e krijuar në arsimin gjithëpërfshirës. Çmimi u dorëzua në Beograd, Serbi.

Në 2008 MEDPAK u nderua me **çmimin për “Punën më të mirë në Arsim”** për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës me fokus arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat. Çmimi u akordua nga FSHDPAK dhe USAID .

Në vitin 2017 është nderuar me **“Çmimin e Vitit” nga OSBE** për punë të mirë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara .

PARTNERËT

Ndër vite MEDPAK zhvilloi kapacitete dhe u bë partner serioz i donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare dhe lokale në zbatimin e projekteve, si dhe forcoi bashkëpunimin me institucione të nivelit qendror dhe lokal me qëllim mbrojtjen e të drejtave të personave me Aftësi të Kufizuar.

Save the Children në Shqipëri (SCiA),

World Vision,

Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

Rotary Club England,

Fondi i Trajnimeve për Shqipërinë, Angli,

MOVIMONDO,

FSHDPAK,

Pushteti vendor,

Shoqatat që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

DONATORËT

- **Ambasada e Britanisë së Madhe,**
- **Ambasada Amerikane,**
- **Bashkimi Evropian,**
- **CRS,**
- **FSHSHC,**
- **Handicap International,**
- **IRI,**
- **Save the Children në Shqipëri,**
- **Save the Children në Itali**
- **SOROS**
- **UNICEF**
- **USAID**
- **UNDP**
- **World Learning**
- **World Vision Albania**



MEDPAK 25 VITE KUJTIMESH

ANN NORRIS, Qershor 2020

Jam shumë e lumtur dhe e nderuar të shkruaj fjalën përshëndetëse për këtë libër mbi punën e MEDPAK!

Në vjeshtë bëhen plot 25 vite që nga ardhja ime e parë në Librazhd për të mbështetur Shoqatën e Prindërëve dhe për shkak të pamundësisë dhe masave kufizuese të lëvizjes në këtë kohë, e nisa më herët këtë letër.

Mendoj që ka ardhur koha për të kthyer kokën pas për të parë se çfarë ka arritur MEDPAK deri më sot dhe për të menduar sesi do të duket e ardhmja.

Tre muajt e parë të vitit tim të parë ishin të mbushur me takime me prindërit, për të

njohur sesi funksiononte sistemi dhe për të krijuar një miqësi të përhershme me familjen Koka.

Dukshëm në diskutimet tona dilnin në pah tre fushat që MEDPAK donte të adresonte të cilat ishin: arsimi, ndërtimi i një organizatë të fortë dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i komunitetit. Mbjaj mend shumë mirë sesi ti Zela më thojë “dëshiroj që gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të shkojnë në shkollë”. Pasi u largova për t’u kthyer në shtëpi klasa burimore u hap dhe filloi të funksionojë në shkollën “Genc Leka”.

Ne organizuam evente dhe punuam me grupet lokale, por gjëja më e rëndësishme ishte të ndërtonim një skuadër, të thurnim plane dhe jo për një vit, por për shumë vite me radhë. Planet tona ndoshta nuk u ndoqën plotësisht dhe herë pas here kërkonin përmirësime e përshtatje, por ato kanë qënë një udhërrëfyes për ne. E tani arrij të shoh se çfarë ka ndodhur në Shqipëri jo vetëm në Librazhd. Shoh arritjet e MEDPAK-ut në fushën e arsimit në 25 vite dhe është bërë i mundur realizimi i “arsimim për të gjithë”.

Shikoni se çfarë tjetër ka arritur MEDPAK dhe ti Zela bashkë me të:

- Respekt dhe përfshirje për personat me aftësi të kufizuara në Librazhd dhe Shqipëri.
- Një sistem arsimor që siguron përfshirje për fëmijët më aftësi të kufizuara.
- Respekt nga prindërit, kolegët, profesionistët nga fusha të ndryshme të shoqërisë.
- Një rreth të shkëlqyer profesionistësh dhe vullnetarësh të cilët promovojnë vizionin tuaj dhe të atyre që respektojnë MEDPAK-un, punën e tij dhe ndajnë të njëjtat ideale.
- E veçanërisht një familje me të rinj si Dorisi, Brasi, Nesi dhe Erjoni dhe ndoshta brezat e tjerë të atyre që vijnë pas si mbesa e nipërit e tu.

Për sa më sipër e për shumë arsye të tjera të përshëndes përzemërsisht Zela, plot dashuri dhe respekt nga thellësia e zemrës sime.

Po në të ardhmen?

A është momenti për të menduar të ardhmen e MEDPAK-ut? Për shkak të punës suaj ka më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara që largohen më të arsimuar



e edukuar nga shkolla. Ata dhe prindërit e tyre kanë një pritshmëri që do të ketë mundësi më të mira për ta për t'u bërë pjesë aktive e shoqërisë, qoftë në punësimin e tyre, vullnetarizim apo jetesë më të pavarur. Ky është mendimi im, pra që sfida e radhës janë realizimi i shërbimeve për të rinjtë dhe rriturit me aftësi të kufizuara.

Kjo është një detyra e radhës sfiduese, si ajo që hasëm 25 vite më parë.

Duke parë se çfarë këni bërë Nazmiu dhe ti në 25 vite, duket që ju i arritët pasi ato ishin lufta juaj, planet tuaja. Ndoshta nevojitet tani që një grup më i ri të mendojnë e thurin plane për shërbimet e të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. Nëse edhe ata luftojnë për këto plane ashtu si ju ose më tepër, do bëjë që ato të realizohen.

Ndoshta MEDPAK duhet të shohë më të rinjtë e familjes (përfshirë Dorisin), profesionistët e rinj, vullnetarët, prindër dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Ky grup duhet të punojë si skuadër për të thurur plane për shërbime që ata do donin t'i realizonin në këtë fushë. Nëse ata i diskutojnë planet, ashtu siç keni bërë ti dhe Nazmiu, do të bëjë që të luftojnë për planet që thurin dhe t'i realizojnë ato.

Ka gjasa që mund të mos shihen përmirësime për shumë vite, por ato duhen, kush i merr përsipër duhet të fillojë tani. Do ketë shumë vështirësi përfshirë këtu aspektin financiar, por sa më shumë hapen mundësitë drejt BE-së më mirë dhe ndihmuese do jetë. Gjithashtu



komunikimi është përmirësuar dhe të rinjtë kanë mundësi të lidhen me njeri-tjetrin dhe kjo bën që të shtojnë rrethin e tyre të kontakteve anembanë Shqipërisë, sidomos në këtë fushë. E jo si 25 vite më parë ku as telefonat nuk punonin, gjë që e mbaj mend shumë mirë!

Unë mendoj që ti Zela duhet ta mbash një sy hapur ndaj asaj që ndodh dhe të sigurohesh që arsimimi për të gjithë ndodh, të vijosh të nxisësh qeverinë, prindërit dhe mësuesit, për t'u siguruar që përmirësimi vijon. Lejoji anëtarët më të rinj dhe vullnetarët të thurin planet e tyre. Patjetër që mund t'ju ofrosh sugjerimet e tua herë

pas here. Kur punoja si punonjëse sociale shumë vite më parë e mbaj mend sesi manaxherja ime më thoshte 'prindërit duhet t'i duan fëmijët e tyre aq sa t'i lejojnë të shkojnë'.

E ardhmja shtrihet përpara për një brez të ri dhe e shoh sesi Dorisi ndikon në një gjë të tillë. Unë nuk do jetoj aq sa të shoh frytet e një projekti të ri, por do të më falte një kënaqësi shumë të madhe të di se fara që ti, Nazmiu dhe unë mbollëm bashkë në 1995 po vazhdojnë të rriten dhe lulëzojnë.

Urimet e mia më të mira për MEDPAK dhe punën e tij, që të vijojë për më shumë se 25 vite në vijim!





**“Eshtë koha që
ne prindërit t’ju
mësojmë fëmijëve
dhe të rinjve sa më
herët se në diversitet
ka bukuri, ka
gjithëpërfshirje, nuk
ka forcë”**

Zela Koka